

**VENDIM  
PER  
REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK**

Sot me date 7/11/2005 une gjyqtarja e Gjykates se Rrethit Tirane ..... G. R. J., pasi shqyrtova kerkesen dhe materialin e paraqitur nga drejtori i "Trajtim i Studenteve Nr. 2 " sh.a Tirane Z Jani Sota , per regjistrimin e shoqerise tregtare "Trajtim i Studenteve Nr. 2 " Sh.a. Tirane,

**KONSTATOVA SE:**

Shoqeria "Trajtim i Studenteve Nr.2 " Sh.a. Tirane, eshte krijuar ne baze te nenit 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002 "Per disa ndryshime ne ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndemarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me akte te tjera ligjore.

Kerkuesi, Trajtim i Studenteve Nr. 2 " sh.a Tirane ka paraqitur kerkesen per te regjistruar si person juridik shoqerine tregtare ne formen e nje shoqerie anonime "Trajtim i Studenteve Nr. 2 " sh.a Tirane me kohezgjatje pa afat te caktuar, me aksioner te vetem Ministrine e Ekonomise, me kapitali themeltar 391,927,747 leke, ndare ne 391,927 aksione me vlere nominale 1,000 leke secili.

Objekti i veprimtarise eshte: Trajtimi i studenteve te Fakultetit te Inxhinjerise se Ndertimit , te Mjekesise Infiermjerise, dhe Adamemise se Fiskultures me ushqim, fjetje dhe sherbime te tjera.

Dokumentacioni i paraqitur, akti i themelimit, statuti dhe urdheri nr. 186, date 20.06.2005 i Ministrit te Ekonomise jane te plota dhe te bazuar ne ligj dhe si te tilla duhet te pranohen.

**PER KETO ARSYE:**

Ne baze te Ligjit nr. 7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite tregtare" si dhe nenit 33 te Ligjit nr. 7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe formalitetet qe duhen plotesuar ne te",

**VENDOSA:**

Depozitimn nr Rregjistrin Tregtar te Urdheri nr. 186, date 20.06.2005 te Mnistrit te Ekonomise. Regjistrimin si person juridik te Shoqerise Anonime "Trajtim i StudenteveNr. 2 " Sh.a. Tirane, me seli Rr. Artan Lenja, Tirane me kohezgjatje pa afat te caktuar. Aksioner i vetem i shoqerise Trajtim i Studenteve Nr. 2 " Sh.a. Tirane eshte Ministri i Ekonomise. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 391,927,747 leke, ndare ne 391,927 aksione me vlere nominale 1,000 leke secili.

Objekti i veprimtarise eshte: Trajtimi i studenteve te Fakultetit te Inxhinjerise se Ndertimit , te Mjekesise te Infiermjerise, dhe Adamemise se Fiskultures me ushqim, fjetje dhe sherbime te tjera.

Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga:

Zj Jolanda Gjeci

Z Sherif Hoxha

Zj. Ina Likaj

Kunder vendimit lejohet ankimi ne shkalle te dyte

**GJYQTARE**

*Jolanda Gjeci*  
*Sherif Hoxha*

## AKT-THEMELIMI

### I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date 20.06:2005, ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, ne baze te nenit 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002 "Per disa ndryshime ne ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me akte te tjera ligjore, Ministri i Ekonomise, me cilesine e aksionerit te vetem te Shoqerise,

#### V E N D O S I:

1. Te krijoje Shoqerine Anonime "Trajtimi i Studenteve Nr. 2" Sh.a Tirane me kapital 100% shteteror.
2. Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte: Trajtimi i studenteve te fakultetit te inxhinierise se ndertimit, te mjekesise, te infermierise dhe akademise se fiskultures, per fjetje dhe ushqim. Ndermarrja ka kontrata pergjithesisht per te gjitha furnizimet per te kryer veprimtarine e saj.
3. Shoqeria do te kete seline e saj ne Tirane. Ajo mund te çele dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise me miratimin e organeve kompetente edhe jashte shtetit.
4. Kapitali themeltar eshte 391,927,747 leke ndare ne 391,927 aksione me vlere nominale 1,000 leke secili.
5. Shoqeria ka nje zgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga:
  - Zj. Jolanda Gjeci
  - Z. Sherif Hoxha
  - Zj. Ina Likaj
7. Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i Shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.
8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.

Anastas ANGJELI  
MINISTËR

